



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 27 Janar 2022

Nr: 7

**V E N D I M**

**P Ë R**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 2, DATË 30.01.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË MONITORIMIT TË MEDIAS AUDIO DHE AUDIOVIZIVE”**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja “ç”, 77, 78, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive” bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, të nenit 1, fjalët “...30 ditore...” hiqen.

b) Pika 1, e nenit 4, riformulohet, si më poshtë:

“1. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.”.

c) Pika 4, e nenit 5, riformulohet si më poshtë:

“4. Për veprimtaritë e institucioneve publike monitorimi i OSHMA-ve fillon 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe bëhet nga ora 08:00-00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit.



Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme afati për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike përcaktohet me akt normativ të posaçëm të Komisionit Rregullator.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**                      **Kryetar**

**Arens ÇELA**                      **Anëtar**

**Dritan ÇAKA**                      **Anëtar**

**Helga VUKAJ**                      **Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**                      **Anëtar**

